

Njoftim për Shtyp Datë 26 Mars 2025

Datë: 26.03.2025



Sot, më datë 26.03.2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. [...] të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 635, 636, 637, datë 31.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli vendosi miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2025 – 2026, për Ndihmës Ligjorë.

Në vijim, Këshilli vendosi miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2025-2026.

Këshilli miratoi vendimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 74, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po ashtu, Këshilli miratoi vendimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e projektvendimit “Mbi miratimin e Rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor”.

Ndër të tjera, Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e projektvendimit “Mbi miratimin e Rregullores “Për vlerësimin e veprimtarisë së nëpunësve civilë gjyqësorë”.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli miratoi raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit [...] për periudhën 2017-2019 si dhe raportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit [...], me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Për shkak të rëndësisë së çështjeve, Këshilli vendosi të shtojë për shqyrtim projektvendimet:

“Për transferimin e gjyqtares znj. Ersida Bajgora në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

“Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtaren znj. Ersida Bajgora”

“Për transferimin e gjyqtarit z. Aulon Pashaj në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.



Kreu	Rreth Nesh	Kontakt	Masat Kundër Covid19	ANTI CORRUPTION POLICY	Njoftime	Dokumentimi i Mbledhjes Plenare	Vendime	Legjislacioni	Programi i transparen
------	------------	---------	----------------------	------------------------	----------	---------------------------------	---------	---------------	-----------------------

Gjithashtu, Këshilli miratoi vendimin për transferimin e gjyqtarit z. Aulon Pashaj në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Këshilli vendosi për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Në përfundim, Këshilli vendosi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 05.02.2025 dhe 13.02.2025.



Njoftime

- [Njoftime](#)
- [Dokumentimi i Mbledhjes Plenare](#)
- [Vendime](#)
- [Legjislacioni](#)
- [Programi i transparences](#)
- [Keshilltari i Etikes](#)
- [QTI](#)
- [Harta e Re Gjyqësore](#)
- [Të Dhënat e Hapura](#)
- [STRATEGJIA E ULJES SË NUMRIT TË ÇËSHTJEVE TË PRAPAMBETURA 2024-2027](#)

Informacion

- [Programi i Transparencës](#)
- [Legjislacioni](#)
- [Vendime](#)
- [Dokumentimi i Mbledhjes Plenare](#)
- [Procesi i Vetëdeklarimit](#)
- [ANTI CORRUPTION POLICY](#)

Lidhjet

- [Gjykatat e Republikës së Shqipërisë](#)